




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulture

04.Nr. 610/01-1743/19
Kaçanik

IN F O R M A T Ë

Për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2018/2019

Hartoi: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Kaçanik, Janar 2019

Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Investimet në infrastrukturën shkollore dhe pajisje tjera
3. Ngritja e cilësisë – zbatimi i Kurrikulës së re
4. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)
 - 4.1. Rrjeti shkollor
 - 4.2. Sukseset e nxënësve – Arsimit fillor
5. Arsimit i Mesëm i Ulët (AMU, VI-IX)
 - 5.1. Nxënësit dhe sukseset e tyre në dy nivelet 1 dhe 2
6. Kuadri arsimor
7. Edukimi dhe Arsimit i Mesëm i Lartë (AML, X – XII)
 - 7.1. Numri i nxënësve
 - 7.2. Sukseset e nxënësve
8. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambarjura të mësimdhënësve
9. Garat shkollore

Shkurtesat:

- DAK- Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- MASHT- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
- PF- Parafillor ose niveli 0
- AF- Arsimit Fillor ose niveli 1 (klasa I-V)
- AMU- Arsimit i Mesëm i Ulët ose niveli 2 (klasa VI-IX)
- AML- Arsimit i Mesëm i Lartë ose niveli 3 (klasa X-XII)
- AJF- Arsimit Joformal

1. Hyrje

Informata për gjysmëvjetorin e parë ka për qëllim të njoftoj institucionet komunale dhe publikun e gjërë mbi gjendjen e përgjithshme në sferën edukativo-arsimore të Komunës sonë për vitin shkollor 2018/2019. Informata përmban punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, respektivisht aktivitetet përgatitore për fillimin e vitit shkollor, furnizimin e shkollave me materiale pedagogjike, furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, regjistrimin e nxënësve në klasat e para dhe klasë të dhjeta, numrin e fëmijëve parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë, zbatimin e Kurrikulës së re dhe suksesi i arritur gjatë këtij gjysmëvjetori.

Përmes këtij dokumenti, në formë tabelare janë prezantuar pasqyrat të cilat ofrojnë të dhëna për numrin e nxënësve sipas shkollave e sipas klasave, suksesi i arritur e të dhëna tjera të përgjithshme. Të dhënat e prezantuara mundësojnë analizimin e gjendjes së përgjithshme në sistemin e arsimit publik që zhvillohet në Komunën e Kaçanikut, në përputhje me Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, e që zhvillohet në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 (Parafillor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë).

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës (DAK) edhe sivjet ka filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/19.

Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve parafillor e fillor, ndërsa në bazë të raporteve të 12 shkollave fillore amë, këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 488 fëmijë në 27 paralele parafillore e 527 nxënës në klasat e para. Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka".

Në Gjimnazin "Skënderbeu" ishin planifikuar të regjistrohen gjithsej 288 nxënës në 9 paralele, ndërsa janë regjistruar 267 nxënës e ndërkaq, në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 344 nxënës në gjithsej 11 paralele, ndërkohë që janë regjistruar 227 nxënës.

Kurse, sa i përket kuadrit arsimor, DAK gjithashtu me kohë e ka publikuar Konkursin për plotësimin e vendeve të lira e më pas janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit dhe kështu është bërë edhe pranimi i kuadrit të ri në të gjitha nivelet. Pjesë e përgatitjeve për vitin e ri shkollor kanë qenë edhe trajnimet e mësimdhënësve për zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës. Gjatë javës së fundit të gushtit, për 6 ditë me radhë janë trajnuar gjithsej 115 mësimdhënës duke përfshirë edhe drejtorët e shkollave dhe zyrtarët e DKA-së, në 5 fusha kurrikulare (Gjuhë dhe Komunikim, Matematikë, Shkenca të Natyrës, Shogëria dhe Mjedisit dhe Mësimi Klasor). Vlen të theksohet se vitin e kaluar janë trajnuar mësimdhënësit e klasave parafillore, të para, gjashta dhe dhjeta (Gjimnaz), ndërsa sivjet janë përfshirë mësimdhënësit të zbatuar programin e Kurrikulës së re në klasën e dytë, shtatë dhe njëmbëdhjetë (Gjimnaz), ndërsa sivjet janë përfshirë mësimdhënësit të cilët më parë nuk kanë ndjekur trajnimet e që sivjet janë duke punuar me klasat e para, gjashta dhe dhjeta (Gjimnaz).

Po ashtu, këtë vit janë trajnuar edhe koordinatorët e cilësisë e të gjitha shkollave të cilat kanë plotësuar kriteret për të pasur koordinatorët e cilësisë në kuadër të shkollave të tyre. Ndërkaq, që edhe gjatë këtij viti ka funksionuar me plotë përgjegjësi edhe Ekipi për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Edhe gjatë këtij viti shkollor, fillimisht të gjitha shkollat janë furnizuar me kohë me materiale pedagogjike, e po ashtu edhe sivjet qeveria e vendit (MASHT), përmes shërbive botuese të kontraktuara, i ka furnizuar me tekste shkollore të gjithë nxënësit e shkollave fillore e të mesme të ulëta (I – IX).

2. Investimet në infrastrukturën shkollore e pajisje tjera

Në Gjimnazin “Skënderbeu” është realizuar projekti “Masat e eficientës së energjisë” i financuar nga MZHE, në vlerë rreth 160 mijë euro. Projekti ka përfshirë rregullimin e kulmit të objektit, izolimin e mureve të jashtme dhe ndërtimin e të gjitha dritareve dhe derve kryesore. Krahës këtij projekti, edhe nga buxheti i Komunës është investuar shuma prej 15 mijë euro, ndërsa projekti përfshirë shtruarjen e dyshemesë së klasave me linoleum.

Po ashtu, MZHE ka investuar edhe në objektin e shkollës së Gajres, paralele e ndarë fizike e SHMU “Idriz Seferi”. Në shkollën e Gajres është investuar në ndërtimin e kulmit dhe izolimin e mureve të jashtme me stiropor, fasadimin dhe instalimin e ngrohjes me avull.

Projekte të financuara nga MASHT në vlerën e përgjithshme prej 78,000 euro

Në objektin e shkollës “Jusuf Gërvalla” në Biçec është rregulluar aneksi shkollor, hapësira ku është vendosur kalldaja e ngrohjes me avull.

Në shkollën e fshatit Nikaj - paralele e ndarë e SHFMU “Jusuf Gërvalla” është renovuar kulmi, fasadimi e izolimi i pjesës së objektit të vjetër dhe rrethoja e oborrit shkollor.

Në shkollën e fshatit Runjevë – paralele e ndarë fizike e SHFMU “Emin Duraku” është bërë rregullimi i oborrit dhe është ndërtuar fusha sportive.

Në shkollën e fshatit Bajnice është ndërtuar aneksi shkollor dhe fusha sportive.

Investime për rregullimin e objekteve shkollore janë bërë edhe nga buxheti i Komunës në shumën e përgjithshme prej 35,768 euro

Në SHFMU “Emin Duraku” në objektin e vjetër janë riparuar shkallët e hyrjes dhe rregullimi i sallës së edukatës fizike.

Në SHFMU “Idriz Seferi” në Bob, në shkollën amë është shtruar me linoleum dyshemja e klasave, ndërkohë që është ndërtuar ndriqimi në fushën sportive.

Po ashtu, me linoleum është shtruar edhe dyshemja e klasave në SHFMU “Qamili Ilazi” në Kacanik të Vjetër (objekti në Fushë të Pajimitit). Në SHFMU “Ali Asllani” në Doganaj është rregullua sala e arsimtarëve dhe njeve sanitare, ndërsa në shkollën 4 klasëshe të Provolisë (SHFMU “Kadri Zeka”) është bërë ndërtimi i dritareve, ljerja e brendshme e objektit dhe rregullimi i njeve sanitare. Ndërkaj në objektin e

SHFMU “Agim Bajrami” në Stagovë janë ndërruar dyert e klasave të pjesës së vjetër të shkollës dhe është shtruar me linoleum dyshemja, ndërkohë që është rregulluar edhe një pjesë e trotuarit. Po ashtu, edhe në shkollën e Kodinës janë rregulluar nyjet sanitare. Nga buxheti i Komunës është intervenuar edhe në dy objektet e shkollave të mesme: Në SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” janë rregulluar mekanizmat e dritareve dhe janë merceturat nyjet sanitare, ndërkaj në Gjimnazin “Skënderbeu” janë shtruar dyshemet e klasave dhe palestës sportive me linoleum.

Objektet shkollore në ndërtim e sipër:

Objekti i SHFMU “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër. Ndërtimi i objektit është duke u financuar nga MASHT, ndërsa projekti është tre vjeçar dhe pritet të përfundoj sipas Kontratës, në vitin 2019 e objekti i shkollës në Gllloboçicë, po ashtu është duke u financuar nga MASHT dhe është projekt dy vjeçar. Përuimi i objektit të ri, modern pritet të bëhet në vitin 2019. Një objekt i ri e modern është duke u ndërtuar në Kovacec dhe është duke u financuar nga buxheti i Komunës. Projekti pritet të finalizohet në vitin 2019.

Në ndërtim e sipër është edhe objekti i Qendrës për Edukimin dhe Arsiminin Parafillor “Agimi” në Kaçanik, projekti i financuar nga fondet e Bashkimi Evropian (BE)

Furnizimi i shkollave me pajisje e mjete tjera mësimore

Pajisja e 2 shkollave të mesme me instrumente muzikore

Përmes Projektit BRICK” (“Building Resilience in Individuals and Communities in Kosovo”), dhe implementuar nga Organizata Integra është bërë pajisja e dy shkollave të mesme, Gjimnazit “Skënderbeu” dhe SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” me instrumente të ndryshme muzikore në vlerë 10 mijë euro ose secila me nga 5 mijë euro. Projekti, përveç tjerash, kështu për qëllim krijimin e një Klubi Muzikor me përfaqësuesit e dy shkollave të mesme, i cili Klub tani ka realizuar disa performanca të shkëlqyera.

Furnizimi me pajisje dhe material shpenzues për kabinetet e Fizikës dhe Biologjisë për 6 shkolla

6 Shkolla fillore dhe të Mesme të Ulëta: SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, SHFMU “Idriz Seferi” në Bob, SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec, SHFMU “Kadi Zeka” në Dubravë, SHFMU “Nazmi Osmani” në Ellezaj dhe SHFMU “7 Shtator” në Begracë, janë furnizuar me pajisje dhe material shpenzues për Kabinetet e Fizikës dhe Biologjisë në shumën e përgjithshme prej 62,487.00 euro ose 10,414.50 euro për secilën shkollë. Mjetet financiare janë siguruar nga Buxheti i Komunës, të dedikuara për DKA.

Furnizimi me pajisje dhe material shpenzues për kabinetet e SHMP-së

Shkolla e Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” është furnizuar me pajisje dhe material shpenzues për:
Kabinetin e sallidimit
Kabinetin e elektrikës
Kabinetin e nxemjes dhe
Kabinetin e kanalizimit dhe ujësjellshit

Furnizimi i shkollave me ormana (dollarë)

Nga Buxheti i Komunës janë siguruar gjithsej 48 dollarë të cilët do të iu shërben shkollave për vendosjen e pajisjeve të ndryshme, ndërkaq atyre iu janë ndarë në proporcion. Po ashtu, mësimdhënësit e të gjitha shkollave janë furnizuar me mantila uniforme për maskuj dhe femra, ndërsa punëtorët teknik janë furnizuar me veshmbathje komplecte të punës.

3. Ngritja e cilësisë - zbatimi i Kurrikulës së re

DAK, si organ menaxhues për çështje të edukimit dhe arsimit fuqimisht mbështet përkujdesjen për ngritje të cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimdhënie dhe mësimnxënie, me theks të veçant zbatimin e Kurrikulës së re (Kurrikulës Bërtamë për Arsimin Parauniversitar) dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfillojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjërë.

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, duke qenë kompetente për zhvillimin e arsimit synon të ndërtojë një shoqëri të arsimuar e të dijtës, një sistem arsimor cilësor i krahasueshëm me arsimin e vendeve të zhvilluara. Ngritja e cilësisë mbetet prioriteti bashkë me ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve por edhe ngritjen e përpjekjeve dhe përgjegjësisë në punë.

Tani më janë afër 115 mësimdhënës të shkollave tona të cilët kanë vijuar trajnimet për zbatimin e Kornizës Kurrikulare në Kosovë të cilët janë në zbatim të këtij programi të ri shkollor. Këtë fillim viti shkollor, janë trajnuar edhe drejtorët e shkollave, për zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës. Ne, në bashkëpunim me MASHT, do të vazhdojnë në ngritjen e kapaciteteve edhe të mëtutjeshme të mësimdhënësve, ndërkohë që presim edhe rezultate më të avansuara në fushën e arsimit.

Ne përmes zbatimit të Kurrikulës synojmë të arrijmë edhe parimet bazë si:

- Gjithëpërfshirja - Përfshirja e të gjithë fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor; e drejta e secilit fëmijë dhe të ri për qasje dhe përfshirje të barabartë në arsimin cilësor, respektivisht ofrimi i mundësisë që secili fëmijë të shpалos vlerat individuale dhe nevojat e tyre të veçanta e njëkohësisht të ndjehet i pranuar dhe i vlerësuar
- Zbatimin e kompetencave
- Mësimdhënja dhe nxënja e integruar dhe koherente
- Autonomia dhe fleksibilitet në nivel shkollë
- Përgjegjësia dhe llogaridhënia
- Zbatimimi i plan-programi mësimor; proces i vazhdueshëm që ndikon në përmirësimin e përvojave të mësimdhënies dhe të nxëniti drejt ngritjes së nivelit të arritjeve të nxënësve
- Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, vlerësim i bazuar në rezultatet e të nxëniti dhe reflektim i performancës së nxënësit gjatë kësaj periudhe
- Sigurimi i mjedisit të pastër dhe favorshëm në shkollë; angazhim i gjithë stafit të shkollës
- Trajnimin e mësimdhënësve si proces i ngritjes profesionale; harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të mësimdhënësve dhe
- Funksionimi i aktiveve profesionale; sigurimi i mundësisë për të përmirësuar cilësinë dhe tejkalimin e vështirësive.

4. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)

Duke u bazuar në plan – programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarrëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në Komunën e Kaçanikut, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim me shkollat dhe komunitetin për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor dhe eliminimin e dobësive me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimdhënje dhe mësimnxënje.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijes, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësi, aftësimi për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi.

Arsimi parashkollor (niveli 0) për fëmijët e moshës pesë vjeç, edhe deri më sot, është trajtuar në mënyrë meritorë duke iu kushtuar vëmendje e veçantë. Në 12 shkollat amë funksionojnë paralelet parafillore, ndërkohë që këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 488 fëmijë të shpërndarë në 27 paralele. Vlen të theksohet se sivjet është hapur paralelja për fëmijët parafillor edhe në SHFMU “Emin Duraku” – Paralelja e ndarë fizike në Runjevë, dhe në SHFMU “Dituria” – Paralelja e ndarë fizike në Strazhë, që për vite me radhë u kishte munguar fëmijëve të këtyre lokaliteteve. Këtë vit shkollor ka filluar të zbatohet puna e edukatoreve me dy grupe fëmijësh, ashtu sikur e saktëson edhe Udhëzimi Administrativ 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parafillore, që do të thotë se fëmijët e një paralele janë ndarë në dy grupe.

Përmes organizimit të këtij niveli shkollor ne synojmë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo fëmije. E po ashtu synojmë ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor të çdo fëmiju.

Arsimi bazë përfshinë nivelet 1 dhe 2 apo arsimin fillor (1-5) dhe arsimin e mesëm të ulët (6-9). Përmes zhvillimit të arsimit bazë, Komuna e Kaçanikut synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.

Arsimi i mesëm i lartë në Komunë e Kaçanikut zhvillohet në 2 shkolla të mesme. Përmes këtij niveli të arsimit ne synojmë zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi, thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Politikat tona zhvillimore janë të orientuara në përfshirjen apo krijimin e mundësisë për çdo nxënësi që përfundon arsimin bazë të regjistruhet në arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, jemi fokusuar në përfshirjen e numrit sa më të madh të nxënësve në drejtimet që ofron Shkolla e Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” e po ashtu edhe në Gjimnazin “Skënderbeu”.

4.1 Rrjeti shkollor

Në Komunën e Kaçanikut funksionojnë 12 shkolla amë dhe 12 paralele të ndara fizike:

1. SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë, Runjevë, Gjurgjedell dhe Kërblig,
2. SHFMU “Idriz Seferi” në Bob me paralelet e ndara në Kovacec e Gajre
3. SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec me paralelet e ndarë në Nikaj
4. SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli

5. SHFEMU "Ali Asllani" në Doganaj
6. SHFEMU "Nazmi Osmani" në Ellezaj me paralelen e ndarë në Bajnicë
7. SHFEMU "Qamil Ilazi" me paralelen e ndarë në Fushë të Pajimit
8. SHFEMU "7 Shtatori" në Begracë
9. SHFEMU "Agim Bajrami në Stagovë
10. SHFEMU "Gafurr Luma" në Gllloboçicë
11. SHFEMU "Dituria" në Ivajë me paralelen e ndarë në Shtrazë dhe
12. SHFEMU "Naim Frashëri" në Kotinë

Përveç shkollave fillore në Komunën tonë funksionojnë edhe 2 shkolla të mesme: Gjinnazi "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" në Kaçanik dhe një çerdhe për fëmijë, QEAP "Agimi" në Kaçanik.

Bazuar në kushtet dhe mundësitë mund të konstatojmë se rriti i shkollave të nivelit AMU, në shumicën e shkollave është deri diku i kënaqshëm, ndërsa në disa lokalitete nuk ka kushte minimale për zhvillimin normal të procesit mësimor. Në Komunën tonë gjatë Periudhës së Parë të këtij viti shkollor kanë funksionuar gjithsej 23 shkolla të nivelit fillor, të plota dhe jo të plota. Ndërkaq, procesi mësimor për klasat VI-IX zhvillohet në 12 shkolla amë dhe në 8 paralele të ndara fizike. Vlen të theksohet se sivjet kanë pushuar së funksionuari shkollat 5 klasëshe me mësim të kombinuar në Llanishtë e Slatinë dhe shkolla 4 klasëshe në Koxhaj, po ashtu me mësim të kombinuar, ndërkaq që nxënësit e këtyre shkollave vijnë në shkollat amë, në Kaçanik dhe Doganaj.

4.2 Suksesi i nxënësve, Arsimi Fillor (1 – 5)

Në nivelin fillor, nga gjithsej 2524 nxënës sa ishin regjistruar në fillim të Periudhës së Parë, kanë vijuar gjithsej 2507 prej tyre, ndërsa sukses pozitiv kanë regjistruar 2483 nxënës, apo shprehur në përqindje 99 %, ndërsa me sukses negativ kanë ngelur 24 dhe 17 të tjerë nuk kanë vijuar ose janë çregjistruar.

Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2018/19, gjithsej 2524, me 2552 sa ishin regjistruar një vit më parë (2017/18), atëherë del se në këtë vit shkollor, 2018-2019, në këtë nivel, janë regjistruar 28 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare e këtij niveli arsimor është 4.05.

Për më shumë të dhëna të nivelit I-V, shih Tabelën Nr. 1

Suksesi në Arsimin Fillor (I - V) në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2018 - 2019

		SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV										TE PANOTUAR							
Klasa		Gj. nxenes		Viljojnë		Shkelq.		Sh. mire		Mire		Mjaft		Gj. pozitiv		%	Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj. negativ		Nuk vijojn		Te çregjif		mesazhi
		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	
I	516	242	513	241	296	168	120	50	64	14	33	9	513	241	100	0	0	0	0	0	0	0	0	3	1	0	0	4.26	
II	501	252	498	250	237	137	116	60	111	44	34	9	498	250	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2	3.96	
III	509	229	504	227	259	137	116	48	94	36	27	8	496	225	98.4	2	0	2	1	4	1	8	2	3	1	2	1	4.03	
IV	482	234	480	233	222	118	109	52	92	40	50	21	472	231	98.3	4	2	3	0	0	0	8	2	1	0	1	1	3.98	
V	516	255	512	252	234	141	133	71	99	30	37	8	503	250	98.2	4	1	5	1	0	0	9	2	1	1	3	2	4.03	
IV	2524	1212	2507	1203	1248	701	594	281	460	164	181	55	2483	1197	99.0	10	3	10	2	4	1	24	6	8	3	9	6	4.05	

5. Arsimi i Mesëm i Ulët (VI-IX)

Numri i nxënësve në AMU në fillim të vitit shkollor 2018/2019 ishte 1999, prej tyre 977 femra, ndërsa nëse e krahasojmë me një vit më parë (gjatë vitit shkollor 2017-2018 ky numri i nxënësve ishte 2122), del se në këtë vit shkollor 2018/19, në këtë nivel janë gjithsej 123 nxënës më pak.

Nga numri i përgjithshëm prej 1999 nxënësve të nivelit AMU, kanë vijuar dhe janë vlerësuar me nota pozitive gjithsej 1562 nxënës apo shprehur në përqindje 79.3 %, ndërkaj me nota negative kanë ngelur gjithsej 410 e 26 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e këtij niveli arsimor del të jetë 3,58.

Për më shumë të dhëna për nivelin VI-IX, shih Tabelën Nr. 2

Suksesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI - IX) në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2018 – 2019

			SUKSESI POZITIV													SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR						
Sa klasat	Gj. nxenes		Vijojnë		Shkelq.		Sh. mire		Mire		Maf.		Gj. pozitiv		%	Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj. negativ		Nuk vijojn Te çregj		Z mes		
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F				
VI	489	233	487	232	160	114	127	61	118	40	30	8	435	223	89.3	18	6	12	2	22	1	52	9	2	1	0	0	3.74
VII	497	273	490	270	169	129	117	74	124	50	21	2	431	255	88.0	32	11	13	4	14	0	59	15	2	1	5	2	3.67
VIII	511	233	503	230	132	90	121	62	88	31	15	7	356	190	70.8	37	14	44	15	65	11	147	40	4	1	4	2	3.45
IX	502	238	493	236	135	92	106	67	93	36	4	3	340	202	69.0	60	19	27	5	66	10	152	34	6	2	3	0	3.44
VI-IX	1999	977	1973	968	596	425	471	264	423	157	70	20	1562	870	79.3	147	50	96	26	167	22	410	98	14	5	12	4	3.58

5.1 Numri i nxënësve dhe suksesi i tyre në të dy nivelet 1 dhe 2 (I-V dhe VI-IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2018/19 ka qenë 4523 (2189 femra) prej të cilëve kanë vijuar gjithsej 4480 prej tyre 2171 femra, ndërsa me sukses pozitiv janë vlerësuar 4045 nxënës prej tyre 2067 femra ose shprehur në përqindje 90.3 %. Ndërsa me nota negative kanë mbetur 434 nxënës prej tyre 104 femra e 43 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë gregjistruar. Nota mesatare e përgjithshme e dy niveleve është 3.84. Nëse e krahasojmë këtë numër të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2018/19 (4523) me numrin e nxënësve të regjistruar një vit më parë (4674) del se gjatë këtij vitit shkollor numri i nxënësve të regjistruar është më i vogël për 151 nxënës.

Për më shumë të dhëna për nivelin I-IX, shih Tabelën Nr. 3

Suksesit sipas klasave I – IX në nivelin fillor dhe mesëm të ulët

Klasa	SUKSESI POZITIV														SUKSESI NEGATIV									TE PANOTUAR		mes Z	
	Gj.nxenes		Vijojnë		Shkelq.		Sh.mire		Mire		Mëft.		Gj.pozitiv		%	Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj.negativ		Nuk vijojn Te çregji			
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F
I	516	242	513	241	296	168	120	50	64	14	33	9	513	241	100	0	0	0	0	0	0	0	0	3	1	0	0
II	501	252	498	250	237	137	116	60	111	44	34	9	498	250	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2
III	509	229	504	227	259	137	116	48	94	36	27	8	496	225	98.4	2	0	2	1	4	1	8	2	3	1	2	1
IV	482	234	480	233	222	118	109	52	92	40	50	21	473	231	98.5	4	2	3	0	0	0	7	2	1	0	1	1
V	516	255	512	252	234	141	133	71	99	30	37	8	503	250	98.2	4	1	5	1	0	0	9	2	1	1	3	2
IV	2524	1212	2507	1203	1248	701	594	281	460	164	181	55	2483	1197	99.0	10	3	10	2	4	1	24	6	8	3	9	6
VI	489	233	487	232	160	114	127	61	118	40	30	8	435	223	89.3	18	6	12	2	22	1	52	9	2	1	0	0
VII	497	273	490	270	169	129	117	74	124	50	21	2	431	255	88.0	32	11	13	4	14	0	59	15	2	1	5	2
VIII	511	233	503	230	132	90	121	62	88	31	15	7	356	190	70.8	37	14	44	15	65	11	147	40	4	1	4	2
IX	502	238	493	236	135	92	106	67	93	36	4	3	340	202	69.0	60	19	27	5	66	10	152	34	6	2	3	0
VI-IX	1999	977	1973	968	596	425	471	264	423	157	70	20	1562	870	79.3	147	50	96	26	167	22	410	98	14	5	12	4
I-IX	4523	2189	4480	2171	1844	1126	1065	545	883	321	251	75	4045	2067	90.29	157	53	106	28	171	23	434	104	22	8	21	10
						</																					

Sukses i nxënëse sipas shkollave prezantohet përmes Tabelës Nr. 4

Nr.	Emri shkoll.	Gjithsej nxënës	Vijojnë		SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV										Të Panotuar		nota mesatare		
					Shkëlq	Shumë mirë		Mirë		Mjaft.		Gjithsej pozitiv		%	1x1		2x1		3x1		Gj negativ		Nuk vijojnë	Çregjishtuar					
						F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj		F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj			F	Gj			
1	"E.D"	1447	711	1428	703	601	369	369	189	259	90	45	14	1274	662	89.22	61	24	35	12	58	5	154	41	11	3	8	5	3.85
2	"K.Z"	415	179	408	178	130	75	91	42	104	45	31	8	356	170	87.25	13	2	12	3	27	3	52	8	0	0	7	1	3.5
3	"I.S"	492	245	491	243	224	139	110	58	106	37	30	7	470	241	95.72	4	0	6	2	10	0	20	2	2	2	0	0	3.97
4	"J.G"	308	149	307	149	119	77	81	38	65	20	24	7	289	142	94.14	6	2	6	2	4	3	16	7	1	0	0	0	3.83
5	"N.O."	335	156	332	155	134	79	82	40	58	24	37	8	311	151	93.67	15	3	5	0	2	1	22	4	2	1	0	0	3.64
6	"Q.I."	418	216	417	215	200	122	99	62	54	17	8	3	361	204	86.57	22	8	10	1	24	2	56	11	0	0	1	1	4.04
7	"A.A"	340	156	336	156	127	70	62	31	70	29	36	13	295	143	87.80	13	5	16	4	12	4	41	13	4	0	0	0	3.69
8	"7.Sh"	307	164	305	162	133	89	50	30	57	24	12	5	252	148	82.62	15	7	12	3	26	4	53	14	2	2	0	0	3.71
9	"G.L."	140	63	140	63	56	33	32	12	41	15	11	3	140	63	100.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3.9
10	"A.B."	153	72	152	71	49	31	53	20	30	10	9	6	141	67	92.76	6	2	2	1	2	1	10	4	0	0	1	1	3.84
11	"Dituri	112	52	108	50	44	25	26	15	30	10	6	0	106	50	98.15	1	0	1	0	0	0	2	0	0	0	4	2	3.97
12	"N.F"	56	26	56	26	27	17	10	8	9	0	2	1	48	26	85.71	1	0	1	0	6	0	8	0	0	0	0	0	3.89
Gjithsej	4523	2189	4480	2171	1844	1126	1065	545	883	321	251	75	4045	2067	90.29	157	53	106	28	171	23	434	104	22	8	21	10	3.84	

6. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të arsimtarëve

Për t'u arritur sukses i dëshiruar, komponentë e rëndësishme është vijueshmëria e rregullt e arsimtarëve dhe nxënësve në mësim. Ndryshe, mosvijimi i rregullt në orët e mësimi ndikon negativisht në suksesin e nxënësve, ndërkohë që ky faktor merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së dhur në shkollë.

Në dy nivelet arsimore (I – IX), në këtë gjysmëvjetor janë angazhuar gjithsej 348 arsimtarë (155 femra) prej tyre 139 në mësimin klasor dhe 209 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë 340 apo shprehur në përqindje 97.7 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU, përkatë këtij gjysmëvjetori, kanë bërë gjithsej 37439 mungesa prej tyre 27044 të arsyeshme, ose 8.35 orë për kokë nxënësi. Ndërkëq, mësimdhënësit gjatë këtij gjysmëvjetori kanë humbur 1045 orë mësimore ose mesatarisht nga 3.0 orë për arsimtarë.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr. 5

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe mesme të ulëta

Nr.	Emri i shkollës	Kuadri arsimor						Mungesat e nxënësve						Mesat për mbajtura të arsimtarëve		Mesatarja për Mesatarja	
		Mësimi klasor			Mësimi lëndor			Dy ciklet			nxënësve			për nx.	arsimtarëve	për arsimtarë	për Mesatarja
		Gj	F	Kv	%	Gj	F	Kv	%	Gj	F	Kv	%	Gj	ARS.		
1	"Emin Duraku"	36	32	33	91.7	45	20	45	100	81	52	78	96.3	13276	9938	9.29	393
2	"Idriz Seferi"	18	10	16	89	21	8	20	95	39	18	36	0.92	2422	905	4.87	155
3	"Kadri Zeka"	14	4	14	100	16	2	15	93.8	30	6	29	96.9	4184	2720	10.08	27
4	"Jusuf Gërvalla"	12	8	12	100	19	5	19	100	31	13	31	100	4335	3014	14.07	66
5	"Camil Ilazi"	10	4	10	100	16	6	16	100	26	10	26	100	3259	2646	7.81	150
6	"Nazmi Osmani"	11	8	11	100	16	7	16	100	27	15	27	100	1446	1245	4.31	41
7	"Ali Aslani"	8	4	8	100	17	3	17	100	25	7	25	100	2907	2197	8.65	41
8	"7 Shtatori"	8	4	8	100	15	9	15	100	23	13	23	100	1610	1189	5.244	39
9	"G.Luma"	5	3	5	100	8	2	8	100	13	5	13	100	1586	1445	11.32	0
10	"A.B."	5	2	5	100	10	2	10	100	15	4	15	100	1002	852	6.59	32
11	"Dituria"	8	4	7	87.5	15	5	15	100	23	9	22	95.7	844	607	7.81	88
12	"Naim Frashëri"	4	0	4	100	11	3	11	100	15	3	15	100	568	286	10.1	13
	Gjithsej	139	83	133	97.3	209	72	207	99.1	348	155	340	97.7	37439	27044	8.35	1045
																	3

7. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (X – XII)

Edukimi dhe arsimimi i nivelit të shkollimit të AML-së i kushtohet përkujdesje e merituar, nga se pikërisht në këtë nivel merren hapat për të vazhduar me sukses studimet superiore. Edhe në këtë nivel arsimor, rëndësi e veçantë është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijes, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësiwe, aftësimit për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që nxënësit të përballojnë sfidat e jetës dhe të punës dhe integritetit më të lehtë të tyre në shoqëri.

7.1 Numri i nxënësve

Në vitin shkollor 2018-2019 në dy shkollat e mesme janë regjistruar gjithsej 1464 nxënës (800 mashkuj dhe 664 femra) prej tyre 781 në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe 683 në SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Është me rëndësi të ceket se këtë vit shkollor në dy shkollat e mesme janë regjistruar 97 nxënës më pak, krahasuar me vitin shkollor 2017/2018 që ishin të regjistruar gjithsej 1561 nxënës në dy shkollat. Në kuadër të Gjimnazit “Skënderbeu” edhe sivityet janë duke funksionuar 2 drejtime me po aq profile: Shkenca Natyrore dhe Shkenca Shoqërore-Gjuhësore, ndërsa në SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” kanë funksionuar 4 drejtime: 1. Elektroteknikë me profilet Teknik i Telekomunikacionit, Teknik i Informatikës dhe Instalues Elektrik, 2. Ekonomi me profilet Banka dhe Sigurime, Tregtar me pakicë dhe shumicë dhe Asistent i Marketingut, 3. Makineri me profilet Transport Rrugor, Instalues i Ngrohjes Qendrore, Instalues i Ujësjetllësit dhe Kanalizimit, Salldator dhe Automekanik dhe 4. Juridik me profilin Asistent Juridik.

7.2 Sukseset e nxënësve

Nga numri i përgjithshëm, 1464 nxënës (664 femra) të regjistruar në fillim të vitit, mësimin e kanë vijuar gjithsej 1414 nxënës, prej tyre 654 femra, ndërsa sukses pozitiv kanë regjistruar 707 ose 50 %.

Me nota të pamjaftueshme kanë mbetur 707 nxënës ose 50 % prej tyre dhe të panotuar e të çregjistruar kanë mbetur gjithsej 50.

Suksesi i arritur reflekton vlerësimin e njohurive të arritura të nxënësve për këtë Periudhë të Parë të vitit shkollor 2018-2019, ndërkaj nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 2.95 dhe atë në Gjimnazin "Skënderbeu" 3.66 dhe SHMP "Feriz Guri dhe Vellezrit Çaka" 2.24.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.6

Suksesi në shkollat e Mesme të Larta në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2018/19

Emri i shkollës	Vendbanimi	Regjistru	Vijojnë	SUKSESI POZITIV										%	SUKSESI NEGATIV									TË PA NOTUAR				Nota mesatare
				Sikëlq.	Sh.mirë	Mirë	Mjaft.	Gj pozitiv	1X1	1X2	1X3	Gjithsej	Nuk vij		Të grejt													
"Skënderbeu"																												
X		262	153	262	153	45	36	74	47	49	33	1	0	169	116	64.50	56	21	22	7	15	9	93	37	0	0	0	3.49
XI		232	150	227	147	73	58	38	25	16	8	2	0	129	91	56.83	54	38	19	6	25	12	98	56	0	0	5	3.8
XII		287	184	285	184	76	62	79	65	29	15	2	0	186	142	65.26	50	24	19	10	30	8	99	42	0	0	2	3.72
X-XII		781	487	774	484	194	156	191	137	94	56	5	0	484	349	62.53	160	83	60	23	70	29	290	135	0	0	7	3.66
X		227	50	200	46	3	0	9	3	30	7	5	0	47	10	23.50	41	6	27	3	85	27	153	36	27	4	0	2.16
XI		218	50	207	48	7	6	10	5	38	10	7	1	62	22	30.00	39	16	31	5	75	5	145	26	11	2	0	2.11
XII		238	77	233	76	15	11	21	11	56	29	22	5	114	56	50.00	44	7	28	5	47	8	119	20	5	1	0	2.46
X-XII		683	177	640	170	25	17	40	19	124	46	34	6	223	88	34.84	124	29	86	13	207	40	417	82	43	7	0	2.24
Gjithsej		1464	664	1414	654	219	173	231	156	218	102	39	6	707	437	50	284	112	146	36	277	69	707	217	43	7	7	2.95

8. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në AML

Vijimi rregullt i nxënësve është faktor i rëndësishëm në procesin mësimor që ka synim nxënien e diturive të reja.

Në fund të kësaj periudhe nxënësit e nivelit të AML-së kanë bërë gjithsej 37506 mungesa (114243 nxënësit e Gjimnazit dhe 23263 ata të SHMP) prej të cilave me arsye 23084 ose 26.52 për kokë nxënësi. Numri i orëve të humbura nga nxënësit dhe arsimtarët është relativisht i

lartë, ndërsa kërkohet nga shkollat përkatëse të ndërmarrin masat e duhura me qëllim të zvogëlimit në minimum të numrit të orëve të humbura mësimore. Ndërkaq, arsimtarët e nivelitë AML-së kanë humbur gjithsej 417 orë mësimi apo 4.04 orë mësimi për arsimtar. Kualifikueshmëria dhe ngrija profesionalizmi është kush elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor për mësimdhënie e mësimnxënie, andaj edhe këtë vit shkollor i është kushtuar vëmendje e veçantë. Kështu, në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtu nivelit janë angazhuar gjithsej 103 mësimdhënës (101 të kualifikuar ose 98.06 %) prej tyre 47 në Gjinnazin “Skënderbeu” me shkallë të kualifikueshmërisë 97.87 % dhe 56 në SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” prej të cilëve 55 të kualifikuar ose 98.21 %.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat e Mesme të Larta

Nr.	Emri i shkollës	KUADRI ARSIMOR				MUNGESAT E NXËNËSVE		Mesatarja për nxënës	Orët e humbura të arsimtarëve	Mesatarja për arsimtarë
		Gj	F	KV	%	Gj	ARSYESHME			
1	"Skënderbeu"	47	22	46	97.87	14243	9170	18.2	189	4.02
2	SHMP	56	17	55	98.21	23263	13914	34	228	4
	Gjithsej	103	39	101	98.06	37506	23084	26.52	417	4.04

9. Garat shkollore

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, me qëllim të nxitjes së nxënësve për thellimin e njohurive të tyre, për çdo vit organizon dhe mban garat shkollore të diturisë në disa lëndë mësimore. Po ashtu, në nivel komunal organizohen edhe gara tjera me qëllim të zhvillimit të shkathësisë e promovimin e talentëve të rinj etj, ndërsa nxënësit e shkollave të Komunës sonë marrin pjesë edhe në garat që organizohen në nivel vendi. Ndërkohë, që në muajin Dhjetor 2018 Instituti ATOML, me përkrahje nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ka nisur të zbatoj Projektin ATOML, i cili ka për qëllim identifikimin dhe përkrahjen e personave me inteligjencë të jashtëzakonshme (atomistë). Nisur nga kjo, DKA-ja ka ftuar të gjitha shkollat që t'i inkurajojnë nxënësit nga klasa e VIII deri në klasën e XII për të aplikuar në projektin ATOML.

Po ashtu, me qëllim të promovimit të talentëve të rinj, inkurajimin dhe motivimin për dije dhe shkencë dhe kërkesës së Gjimnazit “Hasan Nahi”, nxënësit e shkollave të Komunës sonë i janë përgjigjur garës së intelektuale “EUREKA”. DAK e ka përkrahur dhe mbështetur Gjimnazin “Hasan Nahi” për mbajtjen e garës me nxënësit e klasave të IX. Garës që do të mbahet në muajin mars 2019 në nivel vendi i ka paraprijë mbajtja e Testit Përzgjedhës më 15 Dhjetor 2018, në objektin e SHFMU “Emin Duraku” në objektin e vjetër.

Më 17 nëntor 2018 janë mbajtur edhe garat në nivel komunal në futboll të vogël me të gjitha shkollat fillore e të mesme të ulëta në Komunën e Kaçanikut. Në gara kanë marr pjesë 12 ekipe të mashkuve (nga të gjitha shkollat nga 1 ekip) dhe 9 ekipe të femrave (nga të gjitha shkollat përveç shkollës së Kollinës, Bobit dhe Stagovës). Vendi e parë në të dy konkurrencat e kanë marr ekipet e SHFMU “Jusuf Gërvalla”, ndërsa Turneu është mbështetur nga projekti BRICK (Building Resilience in Individuals Communities in Kosovo – Ndërtimi i Qëndrueshmërisë të Individit dhe Komunitetit në Kosovë) dhe organizatën CCPA KOSOVA, organizatë partnere e CDF-së.

Më 3 Nëntor 2018, në objektin e Pallait të Kulturës “Xheladin Kurtaj” është organizuar gara e Robotikës KML (Kosova Makers League) Open Raundi I-rë, me ekipe të nxënësve të shkollave fillore e të mesme të ulëta. Në këtë raund kanë marr pjesë 15 Ekipet nga qendrat rajonale duke përfshirë ekipet nga shkollat e Gjilanit, Ferizajt, Vitija dhe Hani Elezit, ndërsa shkollat e Komunës sonë janë përfaqësuar me 7 ekipe (2 nga SHFMU “Nazmi Osmani” - Elezaj, 2 nga SHFMU “Qamil Ilazi” – Kaçanik i Vjetër, 1 nga Emin Duraku” – Kaçanik, 1 nga “Idriz Seferi” – Bob, dhe 1 nga “Jusuf Gërvalla” – Biçec).

